

Jam shtatëgjatë, zeshkan, flokët i kam të shpeshta. Zoti i Madhëruar më ka dhënë fuqi. Jam kalorës i shkathtë. Thonë për mua se jam shumë i urtë, mendjemprehtë. E dua shumë All-llahun dhe Pejgamberin sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Muhammedi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem më pat caktuar për guvernator në një vilajet. Kur u ktheva më pat pyetur: *“Si janë punët atje?”* lu përgjigja: *“Disi kjo pozitë më ka bërë mendjemadh. Po më duket se unë jam mbi të tjerët...”* Për Zotin e Madhëruar, më kurrë nuk do të vendosem në ndonjë pozitë. Unë jam i sinqertë me vetveten, e di vlerën e forcës, prandaj e dua forcën, por i kam edhe disa pika të dobëta, të cilat mundohem t’i largoj. Kur u caktova për guvernator, vërejtja se mendjemadhësia më mashtroi, andaj u mundova që gjithsesi ta largoj atë, sepse kjo cilësi e keqe nuk përputhet me karakterin tim. Kam dëgjuar prej Muhammedit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem kur tha: *“I lumtur është ai që i ik sprovës.”*

Dëshira ime ishte që ta martoj vajzën e Abdurrahman ibën Aufit, por ai nuk pëlqeu. Muhammedi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, kur më pa të zemëruar, më propozoi kusheriren e tij, Dubaa bint Zubejr ibën Abdul Mutalibin, që me plot dëshirë e pranova.

Në luftën e Bedrit luftova heroikisht. Abdullah ibën Mesudi, kah më kishte parë duke luftuar idhujtarët, më kishte patur lakmi. Një ditë më tha: *“Ah, sikur të luftoja sikur ti, do të ishte më mirë për mua, se ta kem tërë botën.”* Unë jam kalorësi i parë që ka luftuar për fenë Islame (në luftën e Bedrit).

A dëshironi të më njihni?

Fisi im Buhra jetoi në Jemen. Një ndër kryepelqetë e fisit tonë ishte edhe babai im, Amer ibën Malik. Qysh si i vogël kam patur dëshirë të bëhem kalorës dhe luftëtar trim. Para se të di për Islamin, pata një zënkë me një person që ishte i një fisi tjetër, prandaj e vrava.

Fisi i tij kishte filluar të paraqitet për hakmarrje, andaj mua s’më mbeti tjetër, pos të iki diku larg. E zgjodha Mekken. Në Mekke më priu fati, sepse e zura mik Esved ibën Jeguthin, një njeri të cilit i dëgjohej fjala. Ai aq shumë më deshti, sa që më bëri si djallë të vetin. Mbiemrin tim të vërtetë e zëvendësova me mbiemrin e tij. Kështu më quanin, derisa zbriti ajeti kur’anor: ***“Thirrni sipas prindërve të tyre, sepse kjo te All-llahu është më së drejti.”*** Pas këtij urdhëri të All-llahut, prap e ktheva mbiemrin tim të mëparshëm.

Kur i erdhi Muhammedit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem shpallja, me të cilën urdhërohet t’i udhëzojë njerëzit në fenë e vërtetë, mua më kishin kaluar tridhjet vjet. Deshti All-llahu i Madhëruar që edhe mua të më udhëzon në këtë fe, ashtu që edhe unë pranova Islamin.

U kam përballuar të gjitha torturave që kurejshitet i ushtronin ndaj nesh. Ata menduan se me forcë do të na dobësojnë besimin, dhe se do të kthehemi prap në fenë e baballarëve tanë (në idhujtari).

Por kot. Çdo rrahje që bënin mbi ne, na e shtonte edhe më tepër besimin dhe dashurinë ndaj All-llahut dhe fesë së Tij. A e dini pse?

Feja Islame është fe e vërtetë. Ajo ishte jeta dhe dashuria jonë. Me dashuri nënkuptojmë sakrifikim dhe përgjegjësi, andaj edhe e fliuam jetën për këtë fe të pastër.

Sjellja e pabesimtarëve ndaj nesh, e preku shumë Pejgamberin sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Ai e pa se në Mekke është vështirë të jetohet. Aty jeta e muslimanit kishte dhembje dhe vetëm dhembje. Nuk pati zgjidhje tjetër, pos ikjes. E zgjodhëm Abisininë, ku edhe qëndruam një kohë.

Pasi hyri në fe Omer ibën Hattabi, u kthyem në Mekke. Menduam se punët do të vajnë më mirë, por kot. Zemrat e mekasve, të mbushura me urrejtje, mosbesim (kufër) dhe dekadencë, ishin të vendosura që ta luftojnë fenë tonë.

Me urdhërin e All-llahut të Madhëruar, Muhammedi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem u shpërngul në Medine. Unë edhe disa muslimanë tjerë mbetëm në Mekke, por jo për kohë të gjatë, sepse Mekka ishte bërë varr për çdo musliman.

Gjatë periudhës së qëndrimit tim në Mekke, shpesh kam tentuar që me shokun tim musliman, Utbe ibën Gazvanin, të bëjmë plane për ikje në Medine. Çdo njeri prej nesh ankohej nga torturat që na ushtroheshin nga kufarët e Mekkes.

Na erdhi rasti që të shpërngulemi. Dëgjuam se një karvan kurejshit do të kalojë përreth Medines. Shpejt i mblodhëm plaçkat dhe iu bashkangjitëm udhëtarëve. Kur arritëm afër Medines, fshehurazi u arratisëm dhe shkuam në Medine Munevere. Aty gjetëm Muhammedin sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, muhaxhirët dhe ensarët.

Dita-ditës më shtohet dashuria ndaj Muhammedit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem dhe emocionet për përgjegjësinë dhe mbrojtjen e tij. Realizimi i misionit Islamik mvarej nga të gjithë ne, prandaj çdo herë kur dëgjoja se Muhammedit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem i ka ndodhur ndonjë incident, shpejtoja sikur era. Ku ishte Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem isha edhe unë. Isha truproje e tij në shtëpi. Kalin dhe shpatën i mbaja gjithmonë afër. Unë isha i gatshëm për aksion në çdo moment. Edhe pse fenë tonë e ruan All-llahu, edhe ne duhet të kontribuojmë.

Besoje se jeni kureshtar të dini, pse Abdullah ibën Mesudi më kishte lakmi në luftën e Bedrit?

Përgaditeshim për Bedër. Kurejshit, të cilët kishin zgjedhur kalorësit më të mirë, po i afroheshin Medines. Qëllimi i tyre ishte lufta. Këtë e kishin mënyrë të vetme për ta shuar dritën e fesë sonë, Islamit.

Pejgamberi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem na tuboi të gjithëve dhe kërkoi që të konsultohemi. Foli Ebu Bekër Siddiku, e më pas edhe Omer ibën Hattabi. Kuptohet se unë nuk desha të flasë para tyre, sepse ata kishin më tepër merita për suksesin e fesë Islame dhe më

tepër autoritet para Muhammedit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem.

Pasi përfunduan fjalimin ata dy, mora fjalën dhe iu drejtova Muhammedit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem: *“O i dashuri i All-llahut, vepro si të duash, se ne jemi me ty. Nuk jemi si Beni Israilët që i thanë Musait alejhis-selam: ‘Shko ti dhe Zoti yt, luftoni, e ne do të rrimë këtu ulur dhe do të presim.’ Ne me plot vendosmëri të themi: ‘Shko ti dhe Zoti yt, se ne jemi me Ju.’ Betohe m në Atë që të ka dërguar dhe të ka zgjedhur, sikur të na urdhërosh t’i biem Berkul Gamadit (vend në Jemen), ne do ta kryenim urdhërin tënd. Të gjithë krah për krah do ta luftojmë armikun, derisa Zoti i Madhëruar të na sjell fitoren.”*

Pas këtyre fjalëve inkurajuese për muslimanët, Muhammedi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem u gëzua shumë që ka një ushtri të tillë trime, andaj u lut për mua, dhe tha: *“Luftoni dhe përgëzoni.”*

A e din, përse unë dhe shokët e mi kishim këtë mendim?

Sepse ne jemi besimtarë, kurse besimtarëve nuk u trembet syri; ata luftojnë pa mëdyshje dhe nuk i nënshtrohet askujt, përveç All-llahut. Besimtari i vërtetë nuk e kursen jetën e vet, e as pasurinë, për fitoren e fesë Islame.

A e din ti or vëlla se, të besosh, do të thotë, të sakrifikosh, të sillesh mirë, dhe ta ndjekish rrugën e vërtetë.

Në luftën e Bedrit, mbi kalin tim luftoja si rrufeja. Trimat e kufrit lanë pikat e gjakut në shpatën time. Për ta shpata ime sillte vdekjen, prandaj nga frika iknin. Fitorja ishte e jona. Idhujtarët menduan se do të korrin fitore, sepse ishin më shumë se ne, por harruan se lufta jonë ishte për drejtësi, prandaj Zoti na ndihmoi dhe fituam.

Pasuan edhe shumë beteja tjera. Unë mora pjesë në të gjitha. Kalorës trim dhe ekspert i arteve të luftës. Gjithnjë pranë Muhammedit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem. Nuk brengosem nëse vritem, sepse unë jam musliman dhe luftoj për All-llahun. Ali ibën Ebi Talibi radijall-llahu anhu kishte dëgjuar se Muhammedi sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem kishte thënë: *“Çdo Pejgamber ka pasur shtatë shokë, mbrojtës dhe ministra, ndërsa mua m’i ka dhuruar katërmëdhjetë...”* E ndër ta isha edhe unë. Pas vdekjes së Muhammedit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem xhiahadi nuk mori fund. Ne, muslimanët e vërtetë, u detyruam të luftojmë renegatët që u paraqitën gjatë sundimit të Ebu Bekrit. Por kishim edhe obligime tjera, që të çlirojmë toka të reja (të cilat ishin të fundosura në padrejtësi e dekadencë). Çlirimet morrën hov të madh sidomos në kohën e hilafetit të Omerit radijall-llahu anhu.

Amr ibën Asi ishte nisur me ushtrinë e tij që ta çlirojë Egjiptin. Por pasi nuk kishte arritur t’i tejkalojë muret e fortesës Babilon, i shkruajti halifës, Omerit radijall-llahu anhu, dhe kërkoi përforsim. Omeri radijall-llahu anhu i dërgoi 4000 ushtarë, dhe në krye të tyre caktoi katër as’habë më të dalluar. Omeri radijall-llahu anhu i shkruante Amr ibën Asit: *“Të kam dërguar 4000 ushtarë. Në krye të çdo*

njmijëve kam caktuar nga një komandant që vlen sa njmijë ushtarë: Zubejr ibën Avvami, Ubade ibën Samit, Mesleme ibën Muhbid, dhe i fundit isha unë.”

Një ditë isha ulur dhe bisedoja me disa shokë, kur u afrua një i huaj dhe bëri me gisht kah unë dhe sytë e mi, dhe tha: “Lum për këta sy që e kanë parë Muhammedin sal-lallahu alejhi ve sel-lem.” Ia ktheva: “Pse dëshiron të shohish diçka që Zoti nuk të ka mundësuar të shohish. Pastaj, kushedi se si do të veproje kur do ta shihje Muhammedin sal-lallahu alejhi ve sel-lem.”

Shumë njerëz ishin bashkëkohanikë të tij, por thyen qafën në Xhehennem. Duhet shumë t’i falënderohemi All-llahut të Madhërishtëm që nuk jemi si ata, por jemi besimtarë të Tij dhe dashamirë të Muhammedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem.

Pas vdekjes së Muhammedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem vazhdova me dinjitet të mbroj interesat e fesë Islame. Gjithnjë e kam dashur familjen e Muhammedit sal-lallahu alejhi ve sel-lem, prandaj, pas vdekjes së tij, kur lindën kundërthëniet në mes muslimanëve se kush do të zgjedhet për halife, Othmani apo Aliu radijall-llahu anhum, unë e përmbajta Aliun, mirëpo në zgjedhje fitoi Othmani radijall-llahu anhu, prandaj unë u pajtova.

Mua nuk më pëlqen kur muslimanët konfrontohen mes vete, e mos e bjer Zot të lind fitneja (shpifja), e të vriten mes vete.

Unë nisem nga fakti, se Zoti i jep sundim dhe autoritet kujt të dojë, e ajo për atë nuk është nder, por është përgjegjësi e madhe.

Në periferi të Medines pata ndërtuar një shtëpi. Më saktë, ajo ishte në vendin e quajtur Xherif. U tërhoqa, me qëllim që të kem më tepër kohë t’i përkujtoj ditët e ëmbla që i kalova me Muhammedin sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Çdo moment pranë tij, ishte vërtet i lumtur. I përkujtoja edhe fitoret që i korrim kundër pabesimtarëve dhe armiqëve të fesë Islame.

Në shtëpinë time në Xherf, e lutnja All-llahun e Madhërishtëm që të m’i pranojë ibadetet e mia, dhe gjithnjë e falenderoja që më udhëzoi në fenë Islame. Ju lutem, mos më pyetni për shkakun e tërheqjes sime në shtëpi dhe ndejtjen larg konflikteve mes muslimanëve.

Kush mund të thotë se një gjë e tillë është ikje nga përgjegjësia, dhe se është në kundërshtim me parimet e Islamit, për të cilat dhurova jetën time? Keni durim ju lutem, sa t’ua sqaroj pik-pamjet e mia në lidhje me këtë çështje.

Siç u thashë edhe më parë, unë jam shtatëmadh. Pasi që i kalova të gjashtëdhjetat, barku më ishte rritur, ashtu që nuk isha në gjendje që aktivisht të inkuadrohem në problemet e përditshme. Fitneja dhe karrierizmi kishin gjetur strehim në zemrat e disa muslimanëve. Shpata e muslimanit ishte përlyer me gjakun e muslimanit tjetër. Në një gjendje të tillë, nëse dua të inkuadrohem në jetë, duhet

Klubi studentor

të angazhohem në ndonjë grupacion që e lufton tjetrin. Kurse të dy grupet janë muslimanë, e unë ç’të bëj?

Thashë në vete: “Logjika fetare më ndalon ta ngrej shpatën kundër muslimanit.” Gjakderdhja mes muslimanëve është rreptësisht e ndaluar. All-llahu në Kur’an thotë: **“Me të vërtetë muslimanët janë vëllezër.”** Kurse Muhammedi sal-lallahu alejhi ve sel-lem gjithmonë na ka tërhequr vërejtjen që mos të biejmë në kurtha, siç ishin këto.

Këto pra ishin shkaqet pse unë u tërhoqa në shtëpinë time, pasi që e kisha kryer detyrën time të shenjtë, përhapjen e fesë Islame. Thashë: “Në shtëpinë time do të pushoj, kurse ardhmëria e kësaj feje le të mbetet në duart e gjeneratave të ardhshme.”

Ç’do periudhë ka shtetin e vet dhe burrat e saj. Detyra ime është që, sa të kem mundësi, t’i këshilloj njerëzit. Barku im ishte shkak që u sëmura dhe ndërrova jetë. Ndodhi kjo në vitin 33 hixhrij (v. 655) Më varrosën në Medine Munevere.

A më njohët?

Unë jam Mikdad ibën Amri.

Një ditë, Muhammedi sal-lallahu alejhi ve sel-lem më pat thënë:

“Zoti i Madhëruar më ka urdhëruar që të dua, dhe më ka treguar se edhe Ai ty të do.”

Me të vërtetë, Zoti i do të sinqertit!

Marrë nga libri: „A e di kush jam unë?” të autorit

Muhammed Hamza SA’DAVI,

botuar nga shtëpia botuese „Furkan ISM”

Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur’anore, andaj ndalohej hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.

Boton:

Shoqata Qytetare

Klubi Studentor

e-mail: penastudentore@hotmail.com



A e di kush jam unë?



**MUA MË DO
ALL-LLAHU
DHE KA URDHËRUAR
PEJGAMBERIN
SAL-LALL-LLAHU ALEJHI VE SEL-LEM
QË TË MË DOJË**